

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-25-11241-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja dhe perkrahja e sistemit e-pasuria**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	HELIUS SYSTEM sh.p.k
NUI	K91607030D
Adresa	Rruga Dritan Hoxha
Vendi	Tirana
Kodi postar	1001
Numri Telefonit	0682095748
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Gjergji Mulla
Adresa elektronike	gjergji.mulla@helius-software.com
Data e parashtrimit të ankesës	30.03.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja dhe perkrhaja e sistemit e-pasuria

Ankesa lidhet me Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 19.03.2026, B58 mbi anulimin e prokurimit,

dhe Letrën Standarde të datës 19.03.2026 për tenderuesin e eliminuar B52.

Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit:

- **Njoftimi për kontratë – 12.02.2025**
- **Informacione, sqarime shtesë -I- 16.01.2026**
- **Vendim mbi pezullim – 20.01.2026**
- **Kërkesa për Rishqyrtim – 20.01.2026**
- **Vendim në kërkesën për rishqyrtim- 22.01.2026**
- **Hapja e planifikuar e tenderëve – 26.01.2026**
- **Njoftim mbi vendimin e AK- 19.03.2026**
- **Kërkesë për Rishqyrtim- 24.03.2026**
- **Vendim AK mbi kërkesën për rishqyrtim- 26.03.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A

te LPP-se.

Operatori ekonomik Helius Systems, konform nenit 108/A të Ligjit nr. 05/L-068 për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues më datë 24.03.2026, ku ka shprehur mospajtimet lidhur me eliminimin tonë nga procedura.

Me datë 26.03.2026, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendim, me të cilin kërkesa jonë është refuzuar si e pabazuar. Në arsyetimin e dhënë nga AK janë përsëritur të njëjtat arsye për eliminim, të cilat janë paraqitur edhe në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, pa u trajtuar apo adresuar asnjë nga mospajtimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

(Bashkëlidhur dokumentat referuese)

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita:

- Neni 1 – Qëllimi i LPP
- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 – Barazia në trajtim / Mosdiskriminimi
- Neni 51 – Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes
- Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 62 – Perfundimi I aktivitetit të prokurimit
- Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale
- Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Helius Systems Sh.p.k, në cilësinë e operatorit ekonomik ka marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me objekt “*Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria*”, me nr. të prokurimit 214-25-11241-2-1-1, në vijimësi të së cilës ka marrë njoftimin mbi:

Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 19.03.2026, B58 mbi anulimin e prokurimit,

Letrën Standarde të datës 19.03.2026 për tenderuesin e eliminuar B52,

si dhe

Vendimin e Autoritetit Kontraktues, datë 26.03.2026, në përgjigje të kërkesës sonë për rishqyrtim të datës 24.03.2026, me të cilin **kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.**

(Dokumentacioni referues bashkëlidhur)

Kjo ankesë paraqitet kundër këtyre akteve, për shkak se ato janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe në kundërshtim me përmbajtjen faktike të dokumentacionit të paraqitur nga ana jonë si OE, bazuar në nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si edhe duke shprehur shqetësimet dhe kundërshtimet tona lidhur me mënyrën e trajtimit të dokumentacionit të tenderit të bëra nga AK në këtë aktivitet të prokurimit publik.

AK, në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim, e lidh anulimin e procedurës me transferimin e funksioneve dhe të buxhetit te Ministria e Digitalizimit dhe Administratës Publike, si dhe me disa vlerësime që ka bërë mbi ofertën tonë, duke sugjeruar që këto mund të merren parasysh në një procedurë të ardhshme. **Ky arsyetim, në formën si është paraqitur, nuk qëndron dhe nuk lidhet realisht me ligjshmërinë e vendimit për anulim.**

Referimi ndaj një institucioni tjetër dhe ndaj një procedure “të mundshme” në të ardhmen nuk ka lidhje me këtë procedurë konkrete. Fakti që ka pasur një riorganizim administrativ dhe një zhvendosje të funksioneve apo të buxhetit nuk do të thotë që realizimi i kontratës është bërë i pamundur. Përkundrazi, nga vetë ky arsyetim kuptohet që nevoja për shërbimin dhe fondet përkatëse vazhdojnë të ekzistojnë, vetëm se janë vendosur në një strukturë tjetër. Në këto kushte, kjo situatë nuk mund të përdoret si arsye për anulim, por tregon që objekti i prokurimit mbetet aktual.

Nga ana tjetër, qëndrimi i AK për të vijuar me vlerësimin e ofertës dhe për të dhënë konkluzione mbi të, me idenë që ato të shërbejnë “për herë tjetër”, nuk është në përputhje me mënyrën si funksionon vlerësimi në prokurimin publik. Në momentin që procedura

është anuluar, çdo vlerësim mbi ofertat nuk ka më efekt dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera. Në dijeninë tonë si OE ligji nuk parashikon dhënien e vlerësimeve orientuese për procedura që mund të zhvillohen në të ardhmen, aq më tepër nga një autoritet tjetër.

Për më tepër, një qasje e tillë krijon paqartësi dhe mund të ndikojë në mënyrë të padrejtë në një procedurë të ardhshme, pasi i jep një karakter paragjykues një vlerësimi që është bërë jashtë një procesi të vlefshëm. Në këtë mënyrë, arsyetimi i AK del jashtë kuadrit të çështjes konkrete dhe mbështetet në elemente që nuk kanë peshë juridike për vendimin që është marrë.

Përsa më sipër, referimi ndaj “*Ministrisë së Digitalizimit dhe Administratës Publike*”, si dhe vlerësimet e bëra “*që mund të na shërbejnë*”, apo që “*t’i kemi parasysh në rast se institucioni që ka buxhetin do të tenderojë të njëjtin aktivitet*” nuk mund të konsiderohen si bazë e vlefshme për anulimin e procedurës. Por, për më tepër, ato tregojnë që vendimi nuk është mbështetur në një analizë të qartë dhe të plotë të rrethanave konkrete.

Në vijim të sa më sipër, dhe duke qenë se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues mbështetet në element juridikisht të parëndësishëm dhe nuk qëndron në analizë faktike, vlerësojmë të nevojshme të trajtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet konkrete mbi të cilat është mbështetur vendimi i AK për refuzimin e kërkesës sonë.

Në këtë kuadër, më poshtë paraqiten argumentet tona të bazuara në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e “*e-prokurimit*” dhe në kuadrin ligjor në fuqi.

I. Lidhur me anulimin e procedurës së prokurimit

Lidhur me anulimin e procedurës së prokurimit (19.03.2026) AK ka anuluar procedurën **PAS** hapjes së tenderëve (26.01.2026) duke u arsyetuar me “mungesë fondesh” si pasojë e riorganizimit institucional. Ky vendim mbi anulimin e procedurës së prokurimit është i pabazuar dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, për arsytet e mëposhtme:

Sipas Nenit 62 paragrafi 2.2 të LPP, anulimi për shkak të ngjarjeve objektive lejohet vetëm para hapjes së tenderëve. Pasi tenderat janë hapur, dispozita nuk mund të zbatohet më. Kjo është një kufizim i qartë ligjor që synon të mbrojë sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë dhe të parandalojë arbitraritetin e AK. Ky mekanizëm i anulimit nuk mund të përdoret për të kompensuar mangësi në planifikim apo në vlerësimin e ofertave. Vendimi për anulimin e procedurës nuk është i bazuar në rrethana objektive dhe të paparashikueshme, por në një situatë të krijuar nga vetë AK, dhe si i tillë cenon parimet themelore të prokurimit publik dhe duhet të rishqyrtohet.

Mungesa e fondeve pas zhvillimit të procedurës nuk mund të përdoret si justifikim pasi AK ka detyrimin ligjor të sigurojë mbulimin buxhetor para fillimit të procedurës (Nisja e një procedure pa fonde të siguruara përbën shkelje të parimit të planifikimit dhe menaxhimit

financiar sipas Nenit 6 LPP). Riorganizimi institucional dhe ndarja e buxhetit janë rrethana të brendshme të AK dhe nuk mund të transferojnë pasojat negative tek operatorët ekonomikë. Kjo mungesë e fondeve pas zhvillimit të procedurës nuk mund të përdoret si justifikim për anulim, pasi kjo cenon sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë në procesin e prokurimit.

Anulimi pas vlerësimit teknik të ofertave krijon një kontradiktë të papranueshme: AK fillimisht ka pranuar ofertat tona si të plota, i ka vlerësuar teknikisht, dhe më pas ka anuluar procedurën për një arsye që duhej të ishte verifikuar paraprakisht. Ky mekanizëm bie ndesh me parimin e **proporcionalitetit** dhe **transparencës** të procesit të prokurimit publik (Neni 1, 6 dhe 7 LPP) ku ne si Operator Ekonomik kemi investuar kohë dhe burime për përgatitjen e ofertës, dhe anulimi për arsye të brendshme të AK bie ndesh me parimin e efikasitetit.

I. Lidhur me mos plotësimin e kërkesave dhe aftësinë teknike dhe / ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2 të vendosura në Njoftim për Kontratë dhe DT, specifikisht me vlerësimin e stafit profesional

AK ka skualifikuar me pa të drejtë tre ekspertë të propozuar nga ne, megjithëse dokumentacioni i paraqitur (CV, letra reference datë 23.01.2026, certifikime dhe projekte konkrete) plotëson plotësisht kriteret e tenderit. Vlerësimi i AK është formalist, subjektiv dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 59, 69 dhe 72 të LPP.

1. Për zhvilluesin XH.L

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se **Zhvilluesi 1. XH.L.**

- 1- nuk plotëson kriterin e 5 viteve përvojë në zhvillim database në platformën .NET me SQL Server;*
- 2- profili i tij është më shumë i orientuar drejt sigurisë kibernetike sesa zhvillimit të databazave dhe nuk ka 3 projekte të ngjashme sipas kërkesës.*

Ne si Operator Ekonomik argumentojmë se:

Neni 69 LPP kërkon vlerësimin e aftësisë teknike në bazë të përmbajtjes reale të përvojës, jo vetëm në titullin formal të pozicionit. Përvoja e z. XH.L në .NET SQL Server tejkalon 5 vitet e kërkuara (fillon nga viti 2017). Janë dorëzuar 3 projekte konkrete (.NET SQL): e-Albania 2.0, Eterna Suite (Posta Shqiptare), Sistemi NISA. Certifikimet Microsoft (MCSD, MCSA, MCP) janë dëshmi e pakontestueshme e kompetencës. Interpretimi i AK se “profili është më shumë i orientuar drejt sigurisë kibernetike” nuk është kriter ligjor i parashikuar në DT dhe përbën vlerësim subjektiv të ndaluar nga Neni 59 LPP.

Më poshtë paraqesim detajimin e argumentimit tonë për Zhvilluesin 1.XH.L.

Së pari, dokumentet e tenderit kërkojnë përvojë në zhvillim softuer në platformën .NET me SQL Server, por nuk e kufizojnë këtë përvojë vetëm në një titull formal të pozicionit të punës, por në përmbajtjen reale të angazhimit profesional dhe teknologjitë e përdorura.

Së dyti, nga analiza e CV-së rezulton se përvoja profesionale e z. XH.L në teknologjitë relevante fillon që nga viti 2017 duke vijuar në mënyrë të pandërprerë deri në momentin aktual. Kjo përbën një eksperiencë **mbi 8 vite**, e cila tejkalon qartësisht kërkesën minimale prej 5 vitesh të përcaktuar në DT, ku përfshihet:

- zhvillim në .NET (C#);
- përdorim i databazave Microsoft SQL Server;
- zhvillim aplikacionesh dhe integrim sistemesh.

Përvoja duhet të vlerësohet në mënyrë kumulative dhe funksionale dhe jo e kufizuar vetëm në titullin formal të një pozicioni.

Së treti, në kundërshtim me vlerësimin e AK, sqarojmë se për Zhvilluesin 1.XH.L si OE kemi paraqitur dhe dokumentuar projekte konkrete të natyrës së ngjashme, ku janë përdorur teknologjitë e kërkuara (.NET dhe SQL Server), konkretisht evidentuar në Letër Referencë për XH. L datë 23.01.2026, ku sqarohen 3 projektet ku ka marrë pjesë, si më poshtë:

1. *e-Albania 2.0 – Drejtoi dizajnin dhe implementimin frontend për portalin e përmirësuar kombëtar të e-qeverisjes, që mbulon mbi 1,200 shërbime digjitale. Dorëzoi UI/UX moderne, komponentë të ripërdorshëm dhe siguroi përputhje me standardet e aksesueshmërisë;*
2. *Eterna Suite – Posta Shqiptare;*
3. *Sistemi NISA për Dhomën Kombëtare të Noterëve. Zhvilloi dhe mirëmbajti sistemin për shpërndarjen e pensioneve, kuletat elektronike e-ëallets dhe rregjistrimin e llogarive CIF. Përmirësoi performancën dhe rifaktorizoi kodin egzistues për ta përafruar me standartet modern UX dhe teknologjitë e platformës Microsoft.*

Projektet e sipërcituara dëshmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë përvojën praktike në zhvillim softëare dhe databazash dhe përmbushin kërkesën minimale të tenderit.

Së katërti, Zhvilluesi 1. Xh. L disponon certifikime profesionale të nivelit ndërkombëtar nga Microsoft (si Microsoft Certified Solutions Developer, Microsoft Certified Solutions Associate dhe Microsoft Certified Professional) që përbëjnë provë të drejtpërdrejtë dhe të

pakontestueshme të kompetencës në platformën .NET dhe SQL Server, duke tejkaluar kërkesat minimale të përcaktuara nga AK. të cilat lidhen drejtpërdrejt me teknologjitë e kërkuara, përfshirë:

Active Microsoft Cetifications:

Microsoft Certified Solutions Developer

- Certification Number: G494-7798
- Achievement Date: December 05, 2017
- Certification/Version: App Builder

MICROSOFT CERTIFICATION EXAMS

- 761 Querying Data with Transact-SQL January 31, 2018
- 487 Developing Microsoft Azure and Web Services December 05, 2017
- 486 Developing ASP.NET MVC Web Applications November 21, 2017
- 480 Programming in HTML5 with JavaScript and CSS3 November 14, 2017

Këto certifikime përbëjnë dëshmi të drejtpërdrejtë të kompetencës në zhvillim aplikacionesh .NET dhe përdorim të databazave SQL Server.

Microsoft® Certified Solutions Associate

- Certification Number: G422-2195
- Achievement Date: November 21, 2017
- Certification/Version: Web Applications

Microsoft Certified Professional

- Certification Number: G417-4786
- Achievement Date: November 14, 2017
- Certification/Version: Microsoft Certified Professional

Së pesti, AK ka bërë një vlerësim formal dhe të ngushtë, duke u bazuar vetëm në profilizimin e përgjithshëm të kandidatit dhe jo në përmbajtjen reale të përvojës dhe dokumentacionin e paraqitur. Pretendimi i AK se profili i zhvilluesit është “**i orientuar drejt sigurisë kibernetike**” nuk përbën kriter ligjor apo teknik të parashikuar në dokumentet e tenderit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret si bazë për skualifikim. Një interpretim i tillë përbën një vlerësim subjektiv dhe në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të barazisë në trajtim.

Nga analiza e mësipërme rezulton se, për të zhvilluesin e propozuar XH.L :

- *përvoja profesionale tejkalon kërkesën minimale prej 5 vitesh;*
- *ekziston përputhje e plotë me teknologjitë e kërkuara (.NET dhe SQL Server);*
- *janë paraqitur prova të mjaftueshme dhe të verifikueshme (CV, kontrata, referenca, certifikime).*

2. Për zhvilluesin 2. M.C

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se:

Diploma e zhvilluesit 2. M.C është lëshuar ga Fakulteti i Ekonomisë dhe JO Diplomë Univesitare si Baçelor i shkencave kompjuterike ose Baçelor i inxhinierisë kompjuterike”.

Programi është “Informatikë Ekonomike” dhe jo Shkenca Kompjuterike e pastër dhe jo Inxhinieri Kompjuterike (pra nuk ka plotësuar kërkesat minimale të AK-së të vendosura në Njofim për kontratë dhe DT).

Përsa më sipër, si OE argumentojmë se:

AK ka shtuar një kriter të ri (“*shkencë kompjuterike e pastër*”) që nuk ekziston në dokumentet e tenderit. Kjo shkel Nenin 51 (njoftimi i kritereve të përzgjedhjes) dhe Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve ku vlerësimi duhet të bëhet vetëm

sipas kriterëve të shpallura. Programi “Informatikë Ekonomike” (Bachelor) përfshin programim, databaza dhe zhvillim aplikacionesh, pra plotëson plotësisht kërkesën për “Bachelor i shkencave kompjuterike ose inxhinieri kompjuterike”. Shtimi i kriterëve të reja pas publikimit të DT nuk është i lejueshëm.

Më poshtë paraqesim detajimin e argumentimit tonë për Zhvilluesin 2. M.C

Së pari, dokumentet e tenderit kërkojnë:

- “Diplomë Universitare si Bachelor i shkencave kompjuterike ose Bachelor i inxhinierisë kompjuterike”. **Në asnjë pjesë të tyre nuk parashikohet kërkesa për një diplomë në “shkenca kompjuterike të pastër”, as nuk përjashtohen degët e aplikueshme të fushës së teknologjisë së informacionit.**

Së dyti, programi “Informatikë Ekonomike” i Zhvilluesit 2.M.C përbën një degë të njohur të fushës së teknologjisë së informacionit, e cila përfshin komponentë thelbësorë lidhur me:

- *programimin;*
- *databazat;*
- *sistemet e informacionit;*
- *zhvillimin e aplikacioneve;*

Pra, është një profil që përputhet në thelb me kërkesat e tenderit për zhvillim në platformën .NET dhe përdorim të SQL Server.

Së treti, AK ka kryer një interpretim të zgjeruar dhe të paligjshëm të kriterit, duke shtuar një element të ri (“shkencë kompjuterike e pastër”), i cili nuk është pjesë e dokumenteve të tenderit. Një veprim i tillë bie në kundërshtim me parimin themelor të prokurimit publik sipas të cilit: *kriteret e kualifikimit nuk mund të ndryshohen, ngushtohen apo interpretohen në mënyrë restriktive pas publikimit të tyre.*

Së katërti, një interpretim i tillë bie në kundërshtim edhe me parimin e proporcionalitetit,

pasi:

- injoron përvojën reale dhe të dokumentuar shumëvjeçare në zhvillim softuare;
- i jep prioritet emërimit formal të diplomës mbi kompetencën reale profesionale;

ndërkohë që vetë qëllimi i kriterit është të sigurojë aftësi reale teknike dhe jo një kategorizim formal akademik. Duke i shtuar këtyre kriterëve elemente të tjera, si “**shkencë kompjuterike e pastër**”, AK ka krijuar në mënyrë të paligjshme kritere të reja, të pashpallura, duke cenuar parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

Së pesti, Letra e Referencës datë 23.01.2026 konfirmon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakontestueshme se z. M.C ka realizuar projekte konkrete duke përdorur platformat .NET dhe SQL Server – teknologjitë qendrore të kërkuara nga Dosja e Tenderit.

Sipas letrës zyrtare të referencës, ndër arritjet kryesore evidentohen:

(1) drejtimi i migrimit backend të ERP-së së Postës Shqiptare nga aplikacion desktop në platformën **ASP.NET MVC dhe .NET Core** **Ëeb**, duke integruar mbi 50 shërbime pagesash përmes SOAP dhe REST APIs;

(2) zhvillimi i arkitekturës backend për aplikacionin mobil E-Posta duke përdorur **.NET Core**;

(3) projektimi dhe implementimi i backend-it për sistemin NISA (Notary Information System);

(4) zhvillimi i moduleve backend të mikrosërbimeve për e-Albania 2.0 duke përdorur arkitekturën CQRS; si dhe

(5) përshtatja e Core Banking Systems për institucione financiare, me module për origjinimin e kredive dhe operacionet bankare.

Këto projekte, të dokumentuara me emra konkretë dhe teknologji të specifikuara qartë, dëshmojnë se z. M.C ka mbi 5 vite përvojë të verifikueshme në zhvillim softuare mbi platformën .NET, duke tejkaluar kërkesat minimale të DT.

Çdo pretendim i AK se z. M.C nuk ka eksperiencë adekuate teknike në .NET dhe SQL Server është, pra, faktikisht i pavërtetë dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dokumentacionin e paraqitur.

Nga analiza e mësipërme e fakteve vlerësojmë se, për zhvilluesin e propozuar M.C:

- *përvoja profesionale tejkalon kërkesën minimale prej 5 vitesh;*

- *ekziston përputhje e plotë me teknologjitë e kërkuara (.NET dhe SQL Server);*
- *janë paraqitur prova të mjaftueshme dhe të verifikueshme (CV, kontrata, referenca, certifikime).*

Pra, pretendimi i AK se Zhvillues 2. M.C. nuk përmbush kërkesat bazë të vendosura është juridikisht i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dokumentet e tenderit.

3. Për Analistin e Sistemit

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se:

1. *nuk evidentohet qartë roli formal “Analist Sistemi”;*
2. *nuk dokumentohen në mënyrë të strukturuar 3 projekte specifike në .NET SQL Server;*
3. *nuk paraqiten referenca konkrete që lidhin rolin e analistit me arkitekturë aplikative .NET SQL Server;*
4. *përvoja është më shumë e orientuar drejt IT Governance, Security dhe Project Management,*

si edhe ka konkluduar se **profili është i fortë në IT Governance, Security dhe Project Management., por nuk ka evidencë të mjaftueshme të dokumentuar për përmbushjen strikte të kriterit teknik të kërkuar për këtë pozitë.** Në vlerësim strikt të dosjes sipas kërkesës së tenderit, kriteri teknik për Analist Sistemi nuk konsiderohet i provuar në mënyrë të mjaftueshme me dokumentacionin aktual.

Ndërsa ne si Operator Ekonomik argumentojmë se:

Mbi 20 vjet përvojë në analizë sistemesh, arkitekturë .NET SQL, IT Governance dhe projekte kombëtare (e-Albania, Posta Shqiptare, NISA, sisteme bankare). Letra reference dhe certifikimet (MCP, PRINCE2, ITIL, CISM/CRISC/CISA) konfirmojnë plotësimin e kriterit. AK nuk ka identifikuar as emrin e kandidatit në vendim dhe ka përdorur arsye subjektive (“orientuar drejt IT Governance”). Ky është një vlerësim i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me detyrimin për vlerësim objektiv sipas Nenit 59 LPP

Më poshtë paraqesim detajimin e argumentimit tonë për Analist Sistemi GJM

Fillimisht, vërehet se AK nuk ka identifikuar kandidatin konkret në këtë pjesë të

vlerësimit, duke mos vendosur as initiale apo referencë identifikuese gjë e cila cënon transparencën e procedurës dhe bie ndesh me standardet e një vlerësimi objektiv

Pretendimi i AK që **nuk evidenohet qartë roli formal “Analist Sistemi”** është i pabazuar dhe në kundërshtim me DT, pasi:

- në asnjë dispozitë të DT nuk kërkohet që kandidati të ketë një emërtim formal identik të pozicionit “Analist Sistemi”, por kërkohet përvojë reale dhe funksionale në këtë rol;
- AK ka kryer një interpretim formalist të kriterit, duke e reduktuar atë në një çështje terminologjie dhe jo në përmbajtjen reale të përvojës profesionale që rezulton në një vlerësim të njëanshëm dhe në kundërshtim me parimin e vlerësimit substancial të kapaciteteve teknike;
- nga dokumentacioni i paraqitur, konkretisht CV-ja e kandidatit dhe Letra e Referencës (datë 23.01.2026), rezulton qartë dhe pa ekuivok se kandidati ka ushtruar funksione tipike të analistit të sistemit, duke përfshirë:

o analizimin dhe përkthimin e kërkesave funksionale të sistemeve;

o pjesëmarrjen në strukturimin dhe dizajnimin e zgjidhjeve aplikative;

o angazhimin në projekte konkrete të zhvilluara në platformën .NET dhe SQL Server, siç evidentohet në projektet e listuara në CV dhe të konfirmuara në Letrën e Referencës;

1- Pretendimi i AK se **nuk dokumentohen në mënyrë të strukturuar 3 projekte** nuk qëndron, pasi:

- projektet janë të identifikuar dhe të mbështetura me dokumentacion (CV dhe Letër Referencë datë 23.01.2026), janë të verifikueshme dhe lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e tenderit dhe përfaqësojnë sisteme reale të zhvilluara dhe të implementuara.

Në përmbushje të kriterit për projekte të natyrës së ngjashme, dokumentacioni i sipërcituar paraqet pjesëmarrjen e kandidatit në projekte konkrete si:

- *platforma e-Albania;*
- *sistemi i Postës Shqiptare;*
- *sistemi NISA (Notary Information System);*
- *sisteme bankare (core banking system) si Crimson Albania dhe Iliria Invest,*

projekte të cilat janë sisteme të avancuara informacioni që përfshijnë analizë funksionale, arkitekturë dhe implementim si edhe përbushin në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesën për projekte të natyrës së ngjashme.

1- Pretendimi i AK se **“nuk ka referenca konkrete që lidhin rolin me arkitekturën aplikative”** është faktikisht i pavërtetë. Dokumentacioni përfshin letër reference datë 23.01.2026, e cila konfirmon në mënyrë të drejtpërdrejtë:

- ushtrimin e rolit si System Analyst dhe Project Manager;
- përfshirjen në analizë funksionale dhe arkitekturë sistemesh;
- pjesëmarrjen në projekte komplekse informatike.

Konkretisht, Letra e Referencës datë 23.01.2026 e paraqitur nga OE, shprehet qartë dhe pa ekuivok: *“Paralelisht, në rolin e tij si Project Manager dhe System Analyst, z. Mulla ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në analizimin e kërkesave të biznesit, projektimin e arkitekturave funksionale dhe teknike, si dhe në menaxhimin e ciklit të plotë të projekteve komplekse informatike. Ai ka udhëhequr dhe është përfshirë në analizën e sistemeve dhe ka kontribuar në mënyrë vendimtare këto aftësi në disa nga projektet më të rëndësishme kombëtare dhe financiare, përfshirë: Platformën Kombëtare e-Albania, Sistemin e Postës Shqiptare, Sistemin NISA (Notary Information System), Crimson Albania – Core Banking System dhe Iliria Invest – Core Banking System.”* Ky formulim zyrtar nuk lë asnjë vend për dyshim: roli i System Analyst nuk është thjesht i supozuar apo i nënkuptuar, por konfirmohet shprehimisht dhe me emërtim të drejtpërdrejtë nga punëdhënësi në dokumentin e paraqitur zyrtarisht brenda dosjes së tenderit.

Kandidati GJM i propozuar për Analist Sistemi nga CV rezulton se kandidati ka mbi 20 vite përvojë në IT (1999 – aktualisht), duke ushtruar në mënyrë të vazhdueshme funksione që përbëjnë thelbin e rolit të Analistit të Sistemit, duke qenë i përfshirë në

- analizimin e kërkesave të biznesit;
- përkthimin e tyre në specifikime funksionale dhe teknike;
- përfshirjen në projektimin e arkitekturës së sistemeve;
- koordinimin e zhvillimit dhe implementimit të sistemeve informatike.

si edhe ka kontribuar në projekte komplekse informatike në nivel kombëtar dhe financiar.

- 1- Vlerësimi i AK-së se **përvoja është më shumë e orientuar drejt IT Governance, Security dhe Project Management** nuk përbën arsye për përjashtim, përkundrazi:
- këto fusha janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me analizën e sistemeve;
 - përbëjnë komponentë integrale të rolit të analistit të sistemit;
 - **tregojnë një profil profesional më të avancuar dhe gjithëpërfshirës sesa kërkesa minimale.**

Për më tepër, në aspektin e kualifikimeve teknike, kandidati disponon një sërë certifikimesh ndërkombëtare të nivelit të lartë, përfshirë:

- *Microsoft Certified Professional (2003);*
- *PRINCE2 Foundation në Project Management (2025–2028);*
- *ITIL Foundation në IT Service Management (2025–2028);*
- *CISM, CRISC dhe CISA (ISACA – 2025–2029)*

Këto certifikime lidhen drejtpërdrejt me teknologjitë e kërkuara (.NET dhe SQL Server) duke dëshmuar njohuri të avancuara teknike në strukturën dhe funksionimin e sistemeve si edhe përforcojnë dhe mbështesin përvojën praktike të dokumentuar.

Nga analiza e mësipërme rezulton se, për Analistin e Sitemit të propozuar GJ.M :

- *përvoja profesionale tejkalon kërkesën minimale prej 5 vitesh;*
- *ekziston përputhje e plotë me teknologjitë e kërkuara (.NET dhe SQL Server);*
- *janë paraqitur prova të mjaftueshme dhe të verifikueshme (CV, kontrata, referenca, certifikime).*

Nga analiza e mësipërme rezulton se vlerësimi i AK-së ka shkelur dispozitat e nenit 51, 59 dhe 69 të LPP. Kjo pasi kriteret janë interpretuar në mënyrë të ngushtë dhe joproporcionale, dokumentacioni i paraqitur nuk është vlerësuar drejt, duke rezultuar në një vlerësim të pasaktë dhe të paplotë të aftësive teknike dhe profesionale të kandidatëve.

Përveç shkeljeve të evidentuara më sipër, vlerësimi i kryer nga AK është gjithashtu në kundërshtim me nenin 72 të LPP, i cili përcakton se: *“Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.”* Pasi çështjet e ngritura (përvoja, projektet, diploma dhe roli i kandidatëve) lidhen me sqarim të dokumentacionit dhe jo me mungesë të tij, në këto rrethana, AK ka pasur mundësinë të kërkojë sqarime shtesë, ndërsa mosshfrytëzimi i këtij mekanizmi ka çuar në një vlerësim të nxituar dhe jo të plotë.

Gjithashtu vlerësojmë se Vendimi i AK është i pabazuar, në kundërshtim me parimet themelore të Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe cenon të drejtën tonë për konkurrencë të barabartë. Ne kemi paraqitur ofertën më të ulët (97.500,00 €) dhe dokumentacion të plotë teknik. Anulimi dhe skualifikimet e pabazuara besojmë që kërkojnë ndërhyrje të OSHP-së për të rivendosur ligjshmërinë.

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër si dhe në dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që te:

APROVOHET ne teresi ankesa e operatorit ekonomik Helius Systems sh.p.k.;

ANULOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 19.03.2026 dhe Vendimi i Autoritetit Kontraktues të datës 26.03.2026 mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;

OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues që të kthejë procedurën e prokurimit në fazën e vlerësimit të tenderëve dhe të kryejë rivlerësimin e ofertave në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit dhe Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik HELIUS SYSTEMS sh.p.k. ka pësuar dëme materiale të drejtpërdrejta si pasojë e veprimeve të Autoritetit Kontraktues, duke përfshirë:

1. Kosto direkte të përgatitjes së ofertës: OE ka investuar burime të konsiderueshme njerëzore dhe financiare për përgatitjen e ofertës teknike dhe administrative, duke përfshirë mbledhjen dhe organizimin e dokumentacionit të gjerë (CV-ve, letrave të referencave, diplomave, kontratave të punës, certifikatave nderkëmbetare), përgatitjen e ofertës teknike dhe planin e menaxhimit të projektit, koordinimin e personelit të kualifikuar të përfshirë në ofertë, si dhe kostot e lidhura me paraqitjen e ofertës.

2. Siguria e Tenderit: Siguria e Tenderit e paraqitur sipas kërkesës së DT-së është bllokuar për 120 ditë, duke përbërë përdorim të burimeve financiare të OE-së.

3. Humbje e mundësisë: OE ka refuzuar mundësi të tjera biznesi gjatë periudhës së prokurimit duke mbajtur disponibilitetin e stafit profesional të nevojshëm për realizimin e kontratës, në bazë të besimit të ligjshëm se procedura e prokurimit do të përfundonte në përputhje me ligjin.

4. Dëm reputacional: Vlerësimi i gabuar i stafit profesional të Helius Systems, të cilët janë punonjës me kualifikime të larta të verifikueshme, dëmton reputacionin profesional të kompanisë dhe të ekspertëve të propozuar. Duke pasur parasysh investimin e konsiderueshëm në përgatitjen e ofertës dhe anulimin e procedurës në kundërshtim me ligjin, kërkojmë rishqyrtimin e vendimit dhe rifillimin e procedurës në përputhje me kërkesat ligjore.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*